



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 1605 prot.

Elbasan, më 21.06.2024

VENDIM

Nr. 27, datë .21..06.2024

PËR
SHPALLJEN FITUES PËR POSTIN E AUTORITETIT DREJTUES
"REKTOR" TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
PROF. DR. ELVIRA YZEIR FETAHU

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 39, në Urdhrin nr.101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet publike të arsimit të lartë", në Rregulloren e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", miratuar nga Senati Akademik me vendim nr.29, datë 28.03.2024, Kreu II, neni 6, pika 2, germa "h"; kreu VI, neni 35, pika 12, neni 39 pika 2; në rezultatet e votimit të KZF të 5 (pesë) fakulteteve, KIZ në mbledhjen e tij të datës 21.06.2024,

VENDOSI:

- 1- Të shpallë fitues për postin e autoritetit drejtues "Rektor" të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" Prof. dr. **Elvira Yzeir Fetahu**.
- 2- Ky vendim i përcillet Ministrit të Arsimit dhe Sportit për veprime të mëtejshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtar: Armela Mazrreku

Anëtar: Mustafa Kadzadej

Anëtar: Julian Çota

Kryetar: Florencë Prigri

Anëtar: Behije Gollobërda

Anëtar: Marsel Sulanjaku

Anëtar: Klodjana Maloku

